

DHOMA E POSAÇME E SPECIAL CHAMBER OF POSEBNA KOMORA  
GJYKATËS SUPREME TË THE SUPREME COURT OF VRHOVNOG SUDA  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE KOSOVOON KOSOVA ZA PITANJA  
QË LIDHEN ME PRIVATIZATION AGENCY KOJA SE ODOSE NA  
AGJENCINË KOSOVARE RELATED MATTERS KOSOVSKU AGENCIJU  
TË PRIVATIZIMIT ZA PRIVATIZAJU

---

SCC-08-0227

*Paditësi*

NSH Ndërmarrja Hoteliere Turistike "Iliria" Deçan  
Përfaqësuar nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut

Kundër

*Të paditurat*

1. Manastiri i Deçanit
2. Komuna e Deçanit
3. Republika e Serbisë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit ("Dhoma e Posaçme"), Kolegji i Specializuar i përbërë nga Esmë Erterzi, gjyqtare kryesuese, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 27/12/2012, lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

**Padia refuzohet si e pabazuar.**

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 16 tetor 2000, Paditësi ka dorëzuar padi në Gjykatën Komunale në Deçan kundër të paditurve: (1) Manastirit të Deçanit, (2) Komunës së Deçanit dhe (3) Republikës së Serbisë lidhur me verifikimin e pronësisë.

Para konfliktit paditësi ishte person juridik brenda organizatës NHT "Sloga" në Prishtinë, ndërsa e njohur si NSH Ndërmarrja Hoteliere Turistike "Iliria" në Deçan

Më 09.08.1993, NHT "Sloga" dhe i padituri i parë kanë lidhur një kontratë dhurimi me nr. 1235 subjekt i cili ishte dhurimi i parcelave kadastrale dhe objekteve të ndërtuara mbi to nr. 494, 495, 496, 502, 522, 523, 524, 1106, 1107 dhe 528 të regjistruara në listën poseduese 237 KK Deçan, në sipërfaqe totale prej 11.40.51 ha. I padituri i tretë ka miratuar kontratën e dhurimit, sipas kontratës nr.464-2914/97, në favor të të paditurit të parë.

Paditësi ka kërkuar anulimin e kontratës së dhurimit lidhur në mes të NSH-së "Sloga" dhe të paditurit të parë, me numër 1235 të datës 09.08.1993, dhe të numrit të kontratës 464-2914/97 lidhur në mes të paditurit të parë dhe të paditurit të tretë, që të refuzohet si e pabazë dhe e paligjshme, u kërkuar nga Gjykata të verifikoi nëse paditësja Ndërmarrja Hoteliere Turistike "Iliria" në Deçan është pronare e parcelave kadastrale dhe e objekteve të ndërtuara mbi parcelat në fjalë.

Në Gjykatën Komunale në Deçan, rasti është regjistruar nën numrin lëndës C. nr 5/2000.

Më 03.09.2011, Gjykata ftoi paditësin ta ndryshojë padinë (*petitum i kërkesës*) dhe të paraqesë prova në lidhje me objektet e kontestuara.

Më 11.09.2000, paditësi ka dorëzuar padinë e ndryshuar sipas kërkesës së gjykatës. Më 16.10.2001, Gjykata Komunale mbajti seancën, por as i padituri i parë e as i treti nuk u paraqit, seanca është shtyrë për datën 27.11.2001. Edhe në këtë datë të paditurit nuk janë paraqitur dhe seanca është shtyrë, pra për një periudhë kohe të pacaktuar. Më 2001/12/27, të paditurit përsëri nuk janë paraqitur edhe pse ishin thirrur me rregull, seanca është shtyrë për datën 25.01.2002. Më 25.01.2002 të paditurit nuk ishin të pranishëm në seancë, i pari refuzoi thirrjen ndërsa i treti e arsyeton mungesën, prandaj, seanca është shtyrë për datën 21.02.2002. Më 21.02. 2002 seanca është shtyrë për datën 19.03.2002.

Më 28.02.2002, i padituri i dytë Komuna e Deçanit, dorëzoi një parashtresë e cila nuk e kontestonte padinë e paditësit Ndërmarrja Hoteliere Turistike "Iliria" në Deçan, dhe propozoi Gjykatës që padinë e paditësit ta miratojë në tërësinë e saj .

Më 19.03.2002, Gjykata Komunale në Deçan mbajti seancë në të cilën as i padituri i parë e as i treti nuk morën pjesë. I padituri i parë u thirrur në mënyrë të rregullt me Aktin e Gjykatës të datës 03.05.2002 përmes Policisë së UNMIK-ut, por ai nuk iu përgjigj thirrjes, kështu që ajo u shty për datën 18.04.2002. Më 18.04.2002, seanca është mbajtur por përsëri ishte shtyrë për datën 28.06.2002 për shkak se nuk kishte asnjë përgjigje nga Departamenti i Drejtësisë në Prishtinë, për të paditurin e parë dhe të tretë.

Më 28.06. 2002, Gjykata Komunale në Deçan, mbajti seancën kryesore në të cilën paditësi dhe përfaqësuesi i të paditurit të dytë mori pjesë, ndërsa i padituri i parë kishte refuzuar thirrjen dhe i padituri i tretë nuk e kishte justifikuar mungesën edhe pse e kishte marrë thirrjen më 29.04.2002.

Gjykata në kuptim të nenit 295 të LPK-së Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, mori vendim që seanca dëgjimore të mbahet në mungesë të të paditurve, të cilët janë ftuar në mënyrë të rregullt. Pas leximit të padisë, administrimit të provave dhe fjalës përfundimtare të paditësit Gjykata Komunale lëshoi Aktgjykimin me të cilin e anuloi kontratën mbi dhurimin nr.1235 të datës 09.08.1993 dhe kontratës 0464-2914/97, duke vërtetuar se NSH Iliria në Deçan është pronare e parcelave kadastrale dhe objekteve të ndërtuara në parcelat kadastrale nr 494, 495, 496, 502, 522, 523, 524, 528, 1104, 1105, dhe 1107, të regjistruara në fletën poseduese me Nr.131 KK Deçan dhe detyroi të paditurin Manastirin në Deçan, që t'ia kthejnë në posedim dhe shfrytëzim të lirë paluajtshmerinë paditësit.

Gjykata Komunale lëshoi aktgjykimin në mungesë bazuar në nenin 295 Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK) me arsyetimin se gjykata në vazhdimësi për thujt një vit i ka ftuar në mënyrë të rregullt disa herë të paditurit e parë dhe të tretë; i padituri i parë ka refuzuar ftesat ndërsa i padituri i tretë, edhe i ka pranuar ftesat në mënyrë institucionale, nuk e ka arsyetuar mungesën e vetë.

Sipas Gjykatës Komunale kontrata e dhurimit është lidhur në vitin 1997 ndërsa Rregullorja Nr.1999/2004 e datës 12.12.1999, e cila ka hyrë në fuqi më 10 qershor 1999, parasheh se ligjet e aplikueshme në Kosovë janë ligjet në fuqi prej datës 22 mars 1989. Gjykata ka theksuar se paluajtshmeria kontestuese e dhuruar me anë të kësaj kontrate nuk ka qenë asnjëherë pronë e Manastirit të Deçanit, është e vërtetuar nga historiat, i të dhënave kadastrale dhe fleta poseduese se kontrata nuk është valide; dhe se ajo është lidhur në kundërshtim me nenin 4 dhe 5 të Ligjit mbi qarkullimin e pasurisë së paluajtshme (Gazeta Zyrtare 28/88). Dhe se ajo ishte lidhur gjatë kohës së masave të dhunshme. Gjykata ka vendosur që kontrata e lidhur në mes të paditurit të parë dhe të paditurit të tretë të anulohet dhe si e tillë ajo është e pavlefshme dhe e kundërligjshme, pasi që i padituri i tretë ia ka dhuruar të paditurit të parë paluajtshmerinë, që nuk i takon atij por që është pronë e NSH-së dhe punëtorëve të saj.

Më 03.09.2002, avokati i të paditurit të tretë, avokat i shtetit, parashtrori një ankesë kundër këtij aktgjykimi pranë Gjykatës së Qarkut në Pejë, duke e kundërshtuar atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të nenit 354 paragrafi 2 pika 7 e (LPK-së), në lidhje me mungesën e pjesëmarrjes së palëve në seancën dëgjimore, përdorimi i gjuhës së palës në procedurë në pajtim me nenin 354 paragrafi 2 pika 8 i LPK-së. Ai pohoi gjithashtu, për sa i përket pronësisë së parcelave në fjalë, deri në vitin 1964 pronat e paluajtshme ishin pronë e të paditurit të parë Manastirit të Deçanit dhe se këto prona janë prona shtetërore të paditurit të tretë.

Më 26.09.2002, paditësi është përgjigjur ndaj ankesës së të paditurit.

Me 25.10.2005 Gjykata e Qarkut në Pejë lëshoi një aktgjykim me të cilin prishi në tërësi aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Deçan Cnr.88/2001 të datës 28.06.2002, dhe çështjen e ktheu në Gjykatën Komunale për rigjykim me arsyetimin se aktgjykimin i atakuar ka shkelur nenin 354 paragrafi 2 pika 8 të LPK-së, e cila përcakton që Gjykata gjatë Procedurës Kontestimore duhet të vendosë brenda limitit të kërkesave. Gjithashtu kishte shkelje të nenit 354 paragrafi 2 pika 8 të LPK-së, në dërgimin e pa rregullt të shkresave gjyqësore. Gjykata e Qarkut gjithashtu vërejti se Gjykata e shkallës së parë, gjatë rigjyimit, duhet të konsiderojë parregullsinë e padisë në aspektin e legjitimitetit të palëve dhe mundësinë e ndryshimit të padisë në mënyrë që ajo të bëhet e kuptueshme.

Pas prishjes së aktgjyimit lënda merr numër të ri Cnr.326/05.

Më 24.11.2006, Gjykata Komunale në Deçan ka ftuar paditësin që ta precizojë padinë në aspektin e legjitimitetit dhe mundësinë e rregullimit të kompensimit të kërkuar në padi.

Me 7.12.2006, paditësi ka parashtruar precizimin e padisë për çështjen e legjitimitetit të palëve dhe thotë se ka legjitimitet të palës në procedurë sepse e njëjta është subjekt i regjistruar në bazë të aplikimit për Regjistrim të Përkohshëm të Biznesit pranë UNMIK-ut.

Më 13.6.2007, AKM-ja, ka bërë kërkesë për tërheqjen e lëndës në bazë të nenit 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13. Dhoma e Posaçme, në lëndën nr. RR-08-0002, ka tërhequr padinë kundër të gjithë të paditurve pranë Gjykatës Komunale në rastin nr. C.no. 5/2000-(325/05) ku palët në procedurë janë NSH Iliria, Deçan kundër Manastirit të Deçanit, Komuna e Deçanit dhe Republika e Serbisë.

Më 17 nëntor 2008, Dhoma e Posaçme mbajti seancën e parë në këtë Gjykatë në lëndët SCC-08-0226 (padija e Apiko përfaqësuar nga AKM-ja) kundër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit, SCC-08-0227 (padija e NSH Iliria kundër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit) dhe SCC-06-0484 (padija e Ali Demeukaj kundër Republikës së Serbisë dhe Manastirit të Deçanit, Komunës së Deçanit, NSH Apiko, Zenun Mecaj dhe AKM) por pa i bashkuar lëndët për shkak të lidhjes së tyre të ngushtë. Seanca ishte në lidhje me meritat e padive por vetëm për çështjet procedurale dhe regjistrimet e tokave në shënimet kadastrale. Është kundërshtuar përfaqësimi i NSH-së nga AKM-ja dhe është dëgjuar qëndrimi i NSH-së ndryshe nga ai AKM-së. Përfaqësuesi i komunës gjithashtu ka qenë i pranishëm në atë seancë.

Sa i përket përfaqësimit të NSH-së; më 24 nëntor 2008, AKM-ja / Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore ka dorëzuar një parashtrësë duke diskutuar autoritetin e saj mbi NSH-në dhe pozitën e saj juridike në procedurë, si dhe ndryshimet e bëra në regjistrat kadastrale, gjatë rrjedhës së viteve. Ndërkohë më 26.11.2008, avokati i NSH Iliria dorëzoi një parashtrësë në gjuhën shqipe disa pjesë të neneve të përmendura aty u ofruan edhe në gjuhën angleze. Më 01.12.2008, avokati i Komunës ka dorëzuar një parashtrësë vetëm në gjuhën shqipe.

Më 10 mars 2009, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme vendosi që Zyra Ligjore e UNMIK-ut mbanë qëndrim ligjor në lëndë si përfaqësuese e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar interesat e ndërmarrjeve pranë Dhomës së Posaçme dhe në veçanti në këtë lëndë. Gjithashtu në arsyetimin ligjor përmendet se Dhoma lejon NSH-në që të

përfaqësohet nga këshilltarët e saj me përjashtim të rasteve dhe vetëm kur AKM/UNMIK vendos që të ushtrojë autoritetin e vetë administrativ mbi NSH-në. Aktvendimi është kundërshtuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Në anën tjetër Trupi Gjykues me anë të aktvendimit të vetë të datës 18 maj 2009 e ka ftuar në gjykim AKP-në për çdo interes që mund të ketë në emër të NSH-së paditëse.

Më 12.05.2009 AKM/Zyra Ligjore e UNMIK-ut ka dorëzuar parashtresë për të dyja lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 dhe parashtrori një kërkesë për seancë dëgjimore. Në këtë parashtresë, deklarohet se AKM-ja do të pajtohej për një ujdë të propozuar e cila nuk do të kundërshtonte të drejtat e pronësisë së Manastirit të Deçanit për sa i përket ngastrave kadastrale, të cilat aktualisht ndodhen nën Zonën Speciale që përfshinë Manastirin dhe oshënarinë e saj, sipas Vendimit Ekzekutiv të UNMIK-ut Nr.2005/5 dhe do të hiqte dorë në emër të paditësve në lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 dhe në emër të ndonjë NSH-je tjetër nën administrimin e parashkruar dhe autoritetin e çdo të drejte pronësore që ata mund të kenë për ngastrat e tilla.

Palët janë thirrur në seancën dëgjimore të mbajtur më 19 maj 2009 për të shqyrtuar mundësinë e marrëveshjes. Teksti i marrëveshjes me shkrim, pa nënshkrime, paraqitur në Gjykatë që i ishte bashkangjitur parashtresës së Manastirit të datës 15.5.2009 nga Gjykata; megjithatë, nuk mund të përcaktohet nga Gjykata cilës palë i është dorëzuar.

Seancat dëgjimore të lëndës nr. SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227 janë mbajtur së bashku më 19 maj 2009.

Gjatë kësaj seance;

Përfaqësuesi i Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore ka deklaruar se UNMIK-u ka hequr dorë nga paditë kundër Republikës së Serbisë dhe Komunës së Deçanit sipas Nenit 193 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (4/1977 i plotësuar). Në emër të NSH-së, Zt. Teki Bokshi, i dëgjuar vetëm në cilësinë e avokatit të NSH-së Iliria (jo për NSH-në Apiko) ka deklaruar, me citim nga procesverbali, se: "... si përfaqësues i NSH-së Iliria më 24 nëntor 2008 ne kemi bërë një parashtresë ku kemi tërhequr padinë kundër Komunës së Deçanit meqë kemi kontradiktë të interesit me komunën e Deçanit dhe për këtë arsye, Komuna e Deçanit nëpërmjet parashtresës me shkrim e ka pranuar tërheqjen dhe na u ka bashkuar neve si ndërhyrëse e NSH-së që unë e përfaqësoj". Përfaqësuesi i Komunës së Deçanit ka deklaruar se ai e ka pranuar tërheqjen e NSH-së, por jo tërheqjen e UNMIK-ut, por pastaj e ka konfirmuar pranimin e tërheqjes. Avokati i Komunës e ka përsëritur se e kupton se tani Komuna është ndërhyrëse. Gjyqtarja kryesuese ka njoftuar se Kolegji do të vendoste për tërheqjen e padive kundër Komunës dhe Republikës së Serbisë dhe do të konsideronte kërkesën e bërë në lidhje me kërkesën e ndërhyrjes të Komunës.

Përfaqësuesi i Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore - AKM-së dhe ai i Manastirit kanë dhënë deklaratat e tyre gjatë seancës për marrëveshjen. Ata kanë nënshkruar procesverbalin e seancës në data të ndryshme. Avokati i NSH-së e ka shprehur kundërshtimin e tij në lidhje me atë se UNMIK-u nuk mund ta përfaqësojë paditësen NSH Iliria dhe se AKP-ja është pasuesja ligjore e AKM-së.

Më 8 qershor 2009, avokati i NSH Iliria ka paraqitur parashtresë ku shprehen protestat e punonjësve të punëtorëve dhe menaxhmentit të ndërmarrjes Iliria dhe ku përsëriten argumentet se AKP-ja është agjencia e vetme që mund ta përfaqësojë NSH-në si pasuese e AKM-së, se UNMIK-u është duke marrë anën e Manastirit të paditur dhe se Gjykata nuk e ka dëshmuar objektivitetin dhe paanësinë e saj dhe se ajo duhet të përjashtohet nga kjo çështje. Ai ka deklaruar se ata kërkojnë nga EULEX-i që të caktojë një tjetër trup gjykues i cili nuk ka qenë i përfshirë deri tani (*vlen të theksobet se përbërja e trupit gjykues ka ndryshuar disa herë që nga barta e procedurave në Dhomën e Posaçme si në kuadër të mandatit të UNMIK-un ashtu dhe në kuadër të mandatit ekzekutiv të gjyqtarëve të EULEX-it*). Ai gjithashtu ka deklaruar se ata kërkojnë nga Gjykata Kushtetuese ta anulojë vendimin e trupit gjykues të datës 10 mars 2012 në të cilin thuhet se Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore ka të drejtën e vetme për të

përfaqësuar ndërmarrjet në procedurat e mbajtura në lëndën nr. SCC-08-022 ; SCC-08-0227 dhe SCC-06-0484. *(Kolegji i specializuar vë në dukje se nuk ka asnjë dokument në dosje që tregon se është bërë një kërkesë e tillë në Gjykatën Kushtetuese kundër atij aktvendimi.)*

Më 24 korrik 2010, Kolegji i Ankesave e ka dhënë aktvendimin në apelin e AKP-së kundër aktvendimit të trupit gjykues të datës 10 mars 2009 për të tria lëndët (SCC-08-0226, SCC-08-0227 dhe SCC-08-0484) ku vërtetohet aktvendimi i trupit gjykues me të cilin ishte përcaktuar se Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore e ka pozicionin (të drejtën) e vetme ligjore në emër të NSH-ve, në lëndën nr. ASC-09-0025. *(Kolegji i specializuar gjithashtu vë në dukje se nuk ka asnjë dokument në dosje që tregon se ndokush ka bërë aplikim të tillë në Gjykatën Kushtetuese kundër aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të datës 24.7.2010, as në lëndën nr. ASC-09-0025.)*

Nga ana tjetër, për sa i përket marrëveshjes së shprehur gjatë seancës dëgjimore së 19 majit 2009;

Më 10 korrik 2009, UNMIK-u ka paraqitur kërkesë në Dhomën e Posaçme në të cilën ka kërkuar lëshimin e procesverbalit të vërtetuar dhe një kërkesë për urdhër për zbatimin e marrëveshjes së arritur në seancën dëgjimore të mbajtur 19 maj 2009.

Më 26 tetor 2009, në përgjigjen e tij në urdhrin e Gjykatës, UNMIK-u ka përsëritur kërkesën e tij për lëshimin e kopjeve të vërtetuara të procesverbalit të seancës së mbajtur më 19 maj 2009 dhe urdhrin për ekzekutimin e marrëveshjes.

Më 9 shkurt 2011, Trupi Gjykues ka hedhur poshtë kërkesat e UNMIK-ut të datës 10 korrik 2009 dhe 26 tetor 2009. Këtë herë ishte ngritur ankesë kundër këtij aktvendimi nga UNMIK-u.

Më 27 dhjetor 2011, Kolegji i Ankesave e ka dhënë aktvendimin e tij në lëndën nr. ASC-11-0038 ku vërtetohet aktvendimi i trupit gjykues i datës 9 shkurt 2011 ku konstatohet se marrëveshja nuk është kryer ende dhe që ekzekutimi i marrëveshjes nuk është në juridiksionin e Dhomës së Posaçme, në asnjë rast, ndërsa në të njëjtën kohë, deklarohet se trupi gjykues duhet të kishte caktuar një tjetër seancë dëgjimore për t'u mundësuar palëve të përfundonin marrëveshjen e tyre të shprehur më 19 maj 2009 me rregullat procedurale.

Më 1 janar 2012, ka hyrë në fuqi Ligji i ri nr. 04/L-033 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Me vendimin e Presidiumit të Dhomës së Posaçme Nr. 1/2012, të datës 2 shkurt 2012, janë themeluar Kolegjet e specializuara. Lënda i ishte caktuar fillimisht Kolegjit 4. Si rezultat i vendimit të Presidiumit Nr. 19/2012 të datës 20 qershor 2012, lënda i është ndarë Kolegjit 3 (Kolegjit të pronësisë).

Kolegji i specializuar i padive pronësore, sipas kërkesës së UNMIK-ut dhe mendimit të Kolegjit të Ankesave, ka vendosur që të mbahet seancë dëgjimore më 3.10.2012 e cila ishte kërkuar të shtyhej. Seanca dëgjimore ishte mbajtur më 16 tetor 2012.

Më 29.10.2012, avokati i NSH Iliria (jo si avokat i NSH Apiko) ka paraqitur parashtresë vetëm në gjuhën shqipe ku ka kundërshtuar seancën dëgjimore mbajtur në lëndën nr. SCC-08-0227 pa praninë e tij.

Më 30.10.2012, avokati i Manastirit të paditur ka dorëzuar dokumentet e mëposhtme: (1) konfirmimin e statusit për manastiret dhe abacitë në gjuhën serbe dhe angleze (2) një kopje të Vendimit për emërimin e Atit Sava Janjic si Abat i Manastirit të Deçanit.

Më 30.10.2012, Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore i është përgjigjur kërkesës së Kolegjit ku kërkohej sqarimi dhe kontrollimi i palëve që arrijnë marrëveshjen nëse ajo mbulon të gjitha ngastrat në kontestin në fjalë. UNMIK-u ka kërkuar caktimin e një seance tjetër.

Më 6 nëntor 2012, avokati i Komunës gjithashtu ka paraqitur parashtrësë vetëm në gjuhën shqipe ku është kundërshtuar seanca dëgjimore e mbajtur më 16.10.2012 për të dyja lëndët SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227.

Më 19 nëntor 2012, Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore ka paraqitur parashtrësë tjetër ku deklarohet se AKM-ja kishte hequr dorë nga e gjithë e drejta në lidhje me parcelat e përmendura në marrëveshje përveç atyre nga të cilat në mënyrë eksplicite ka hequr dorë Manastiri dhe kjo vlen edhe në rastin kur ku marrëveshja midis palëve nuk radhit shprehimisht të gjitha parcelat që janë në kontest. AKM-ja ka deklaruar se "marrëveshja e negociuar e arritur nga palët dhe e konfirmuar me shkrim bëhet e formës së prerë dhe detyruese për palët" sipas Nenit 26.4 të Urdhërësës Administrative së UNMIK-ut 2008/6 të dhe për këtë arsye, nuk është më në kompetencën e trupit gjykues për të vendosur për të. Në anën tjetër, Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore në parashtrësën e njëjtë ka kërkuar: (1) bashkimin e lëndëve proceduralisht me lëndën nr. SCC-08-0226, (2) Lëshimin e kopjeve të vërtetuara të procesverbaleve të datës 16.10.2012 si dhe (3) marrjen e masave të nevojshme pas lëshimit të këtyre kopjeve të vërtetuara për zbatimin e marrëveshjes duke urdhëruar që të dhënat kadastrale të Komunës të ndryshohen ashtu që të reflektojnë marrëveshjen.

Më 20 dhjetor 2012, avokati i Komunës ka paraqitur parashtrësë tjetër në të cilën ka deklaruar se ai është informuar nga NSH Iliria që seanca dëgjimore do të mbahet më 5.12.2012 në të cilën ishin ftuar vetëm përfaqësuesit e Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore dhe NSH Iliria si dhe Manastiri i Deçanit. Ai ka theksuar se, edhe pse ai ka kërkuar të jetë në anën e paditësit ai ishte përjashtuar si palë nga procedurat më 16.10.2012, Gjykata nuk e kishte ftuar atë në seancë.

Në fakt, seanca e planifikuar fillimisht të mbahet në 13.12.2012 ishte dashur të shtyhej për datën 21.12.2012 bazuar në justifikimin e njëres palë. Përfaqësuesit e palëve të tjera ishin të gjitha të pranishme në atë seancë, si dhe avokati i Komunës në mesin e audiencës. Paraqitja gojore e avokatit të NSH-së është marrë gjithashtu në lidhje me marrëveshjen e arritur në mes të Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore dhe Manastirit të Deçanit.

## **Arsyetimi ligjor**

Kolegji i specializuar do të diskutojë më poshtë argumentet e palëve në mënyrë të veçantë për këtë lëndë.

### **1. Palët**

#### **(a) Paditësi**

Paditësi në lëndën në fjalë është ndërmarrja shoqërore (NSH) "Iliria" emri i së cilës është ndryshuar kohë pas kohe. Statusi i saj si ndërmarrje shoqërore nuk kontestohet nga asnjëra palë e procedurave. Nuk ekziston asnjë paditës apo kundër-paditës tjetër përveç kësaj NSH-je përkundër asaj që duket se ka shumë hisedarë që shprehin lidhjen e tyre me këto procedura në cilësi të ndryshme. Përfaqësimi i tij nga avokati i vet ose pozicioni ligjor i Zyrës së UNMIK-ut për Çështje Ligjore në emër të NSH-së si paditës do të diskutohet më poshtë në detaje.

#### **(b) Autoriteti administrativ i Agjencisë mbi NSH-në paditëse**

Siç dihet, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është themeluar me Rregulloren Nr. 2002/12 të bazuar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) dhe kompetencën e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP). Që nga 13 qershori 2012, AKM-ja ka filluar të ketë autoritet administrativ mbi ndërmarrjet shoqërore. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2002/12, e plotësuar me Rregulloren 2005/18, parasheh që Agjencia do të ketë autoritet administrativ në lidhje me të gjitha ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Për më tepër, në bazë të Nenit 6.2 (d) të të njëjtës, Agjencia e ka të drejtën "të sistemojë paratë dhe asetet e tjera të ndërmarrjeve shoqërore."

Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-034, gjithashtu rregullon autoritetin administrativ të Agjencisë në të njëjtën mënyrë siç ishte paraparë për AKM-në. Neni 6.1 i Ligjit mbi AKP-në, i jep autoritet të gjerë dhe ekskluziv administrativ Agjencisë mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bien brenda fushëveprimit të Neneve 5.1 dhe 5.2. Autoriteti i tillë përfshin çdo veprim që Agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të përshtatshëm, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo një sistemim tjetër të një ndërmarrje, aseti apo interesi në pronësi shtetërore. Ajo ka të drejtë të emërojë dhe të zëvendësojë kryetarin, drejtorët dhe menaxherët e NSH-së.

Në këtë rast, çështja e cila është shume e kontestueshme nuk është autoriteti administrativ i Agjencisë mbi ndërmarrjet shoqërore. Ajo për të cilën debatohet fort është kryesisht është çështja se "cila Agjenci e ka autoritetin administrativ mbi NSH-në", AKM-ja apo AKP-ja?

Çështja e dytë më e kontestuar në këto procedura është se "çfarë ndodh nëse administratori i NSH-së ka pozitë të ndryshme nga drejtorët /menaxherët e vetë NSH-së.

Tani, Kolegji së pari do ta trajtojë çështjen parësore (nëse është AKM-ja e themeluar nga UNMIK-u apo AKP-ja themeluar nga Kuvendi i Kosovës si pasuese e të pares ajo që e administron NSH-në) sa i përket të dytës (çka ndodh kur NSH-ja ka pozitë të ndryshme nga administratori i saj).

### **(c) AKM apo AKP?**

Nëse është AKM-ja apo AKP-ja ajo që e administron NSH-në është diskutuar për një kohë të gjatë në këto procedura. Përgjigja në lidhje me këtë është dhënë jo vetëm një herë por dy herë nga Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme me aktvendimet e përmendura më lart në rrethanat procedurale (Aktvendimi i datës 24.7.2010, lënda nr. ASC-09-0025 dhe aktvendimi i datës 27 dhjetor 2011, në lëndën nr. ASC-11-0038).

Të gjitha argumentet që rrjedhin nga Neni 1.2 i Ligjit për AKP-në, i plotësuar, ku thuhet se AKP-ja është pasuesja ligjore e AKM-së, janë prezantuar nga vetë NSH-ja në mënyrë të përsëritur, nga avokati i saj si dhe nga avokati i Komunës gjatë seancave dëgjimore dhe parashtrësive me shkrim. Përfaqësuesi i AKP-së gjithashtu e ka argumentuar çështjen edhe me shkrim edhe me gojë gjatë seancës së mbajtur më 19 maj 2009 dhe në apelin e tij të parashtruar kundër aktvendimit të trupit gjykues të datës 10 mars 2009. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ka pasur mundësinë që të shprehet se si e kupton ajo këtë përfaqësim me anë të letrës së saj të datës 14 tetor 2009 dhe ka deklaruar se në pajtim me nenin 67.4 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënien (Ligji Nr. 03/L-048, datë 13 qershor 2008) e lejon dhe detyron Ministrinë e Drejtësisë që të përfshihet në procedura. Të gjitha këto argumente kanë qenë në dispozicion të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të shkallës së dytë të asaj kohe dhe janë vlerësuar me aktvendimet e tyre përkatëse për këtë çështje.

Më 10 mars 2009, Trupi Gjykues i asaj kohe kishte konkluduar se Zyra e UNMIK-ut për çështje ligjore, duke përfaqësuar AKM-në, ka pozicion (të drejtë) ligjore në këtë lëndë dhe e ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar interesat e ndërmarrjeve në lëndët para Dhomës së Posaçme dhe në veçanti për lëndët në të cilat ky aktvendim është i aplikueshëm. Me apelin e parashtruar nga AKP-ja kundër aktvendimit të trupit gjykues të datës 10 mars 2009 Kolegji i Ankesave e ka vërtetuar konkluzionin e trupit gjykues (aktvendimi i datës 24 korrik 2010, lënda nr. ASC-09-0025)

Në një aktvendim tjetër të Kolegjit të Ankesave, të datës 27 dhjetor 2011, lënda me nr. ASC-11-0038, në apelin kundër Aktvendimit të Trupit Gjykues, datë 9 shkurt 2011 në lëndët me nr. SCC-08-0226 dhe SCC-08-0227, është përsëritur se përfaqësimi i NSH-së nga AKM-ja dhe Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore është përfundimtar dhe si i tillë i detyrueshëm dhe se nuk mund të vihet në pikëpyetje më dhe madje konsiderohet të jetë res judicata nga Kolegji i Ankesave. Në kohën e lëshimit të atij Aktvendimi, tanimë në fuqi ka qenë Ligji i ri për AKP-në Nr.04/L-034.

Nuk është relevante se a pajtohet apo jo me atë konstatim përbërja aktuale e kolegjit të specializuar. Aktvendimet e formës së prerë janë detyruese jo vetëm për palët, por edhe për të gjitha gjykatat, derisa një ligj i ri ta rregulloj këtë fushë ndryshe, pas miratimit të një aktvendimi të tillë të formës së prerë në një çështje procedurale. Parashikueshmëria dhe parimet e sigurisë ligjore kërkojnë që aktvendimet/aktgjykimet e formës së prerë nuk mund të kundërshtohen më tutje, pa marrë parasysh nëse janë të saktë apo jo, vetëm nëse ekziston një mjet tjetër juridik i jashtëzakonshëm (që akoma i nënshtrohet afatit kohor specifik). Nuk ka asnjë dëshmi apo njoftim në dosje që tregon që ndonjë palë ose person i tretë që pretendon të ketë një interes në këtë rast të ketë kundërshtuar kushtetutshmërinë e aktvendimeve të kolegjit të apelit apo të ketë bërë kërkesë për mjete të jashtëzakonshme në këtë rast të veçantë në fjalë.

Për lëndën në fjalë, kolegji i apelit, në aktvendimin e vet, të datës 24 korrik 2010, ka dhënë përcaktimin se Zyra Ligjore e UNMIK-ut e cila ka të drejtën e vetme për të përfaqësuar NSH-në në kohën kur Ligji mbi AKP-në dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës kanë qenë tanimë në fuqi. Kushtetuta e atëhershme, në nenin 143, i është referuar Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Sipas nenit 143.2 të kushtetutës, dispozitat e Propozimit Gjithëpërfshirës do të kenë epërsi ndaj të gjitha dispozitave të tjera ligjore në Kosovë. Për më tepër, kushtetuta, ligjet dhe aktet e tjera ligjore të Republikës së Kosovës do të interpretohen në pajtueshmëri me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të datës 26 mars 2007. Në rast se ka papajtueshmëri midis dispozitave të kësaj Kushtetute, ligjeve dhe akteve të tjera ligjore të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të marrëveshjes, kjo e fundit do të mbizotërojë (Neni 143.3 i Kushtetutës).

Është fakt shumë i njohur se Propozimi Gjithëpërfshirës (Plani i Ahtisaarit) i jep Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit autoritetin administrativ mbi ndërmarret shoqërore (Shtojca VII i Propozimit Gjithëpërfshirës, Neni 2). Fakti që Kushtetuta sot nuk i referohet Planit Gjithëpërfshirës apo nuk e mbizotëron Kushtetutën nuk është relevant. Të gjitha parashtresat e palëve dhe deklaratat e tyre në lidhje me marrëveshjen dhe nënshkrimi i procesverbalit të seancës dëgjimore ku është shprehur marrëveshja, me përjashtim të dokumentit të fundit, i cili plotësin atë të mëparshmin, janë bërë në një kohë kur një referencë e tillë në Propozimin Gjithëpërfshirës ende ekzistonte në Kushtetutë si me e larta në hierarkinë e normave.

Kolegji i specializuar nuk do të marrë një qëndrim të ri mbi këtë çështje, por vetëm i referohet përcaktimit paraprak të kolegjit të apelit për përfaqësimin e NSH së paditur nga Zyra e Çështjeve Ligjore të UNMIK-ut i cili është vetëm deklarativ tani, por jo konstituv.

#### **(d) Të paditur (-it) e tjerë**

Dosja origjinale e parashtruar pranë Gjykatës Komunale është drejtuar kundër Republikës së Serbisë si i paditur i parë dhe Komunës së Deçanit si i paditur i dytë dhe Manastirit të Deçanit si i paditur i tretë. Gjykata Komunale para tërheqjes së padisë kishte vendosur se komuna ka pranuar padinë para tërheqjes se procedurës pranë Dhomës së Posaçme në lëndën me nr. RR-08-0002, të datës 20.06.2008.

NSH tërhoqi padinë dhe UNMIK-u hoqi dorë nga padia kundër Komunës. Komuna pranoi tërheqjen e padisë nga NSH kundër saj. Që të dytë, avokati i NSH Iliria dhe avokati i Komunës së Deçanit pranuan se tërheqja e NSH ishte pranuar nga Komuna në seancën e mbajtur me 19 maj 2009. Veç kësaj, UNMIK hoqi dorë nga të drejtat kundër komunës dhe poashtu kundër Republikës së Serbisë në bazë të Nenit 193 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (4/1977)

Kolegji i specializuar konsideron se deklarata e përfaqësuesit të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut nuk ka kërkuar pëlqimin e Trupin Gjykes. Tërheqja e padisë shprehimisht është rregulluar në UA të UNMIK-ut 2008/6 (tani në nenin 26 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme) i cili kërkon pëlqimin e Kolegjit të Specializuar. Megjithatë, nuk ekziston ndonjë dispozitë e caktuar mbi heqjen



dorë nga të drejtat dhe paditë në asnjërën prej tyre. Prandaj, dispozita e Ligjit të Procedurës Kontestimore (Neni 193 i LPK të vjetër, , Neni 261 i LPK të ri,) është i aplikueshëm, në pajtim me nenin 70 të UA të UNMIK-ut 2008/6 (dhe neni 14 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme) në lidhje me heqjen dorë nga padia që as nuk ka nevojë për pëlqimin e gjykatës e as të të paditurit (-ve). Deklarata e bërë nga përfaqësuesi i paditësit më 19 maj 2009, prandaj, ka prodhuar efektin e vetë ligjor qysh prej asaj date.

Tani, kolegji tërheq vëmendjen në faktin se Republika e Serbisë dhe Komuna e Deçanit nuk janë më palë në këtë procedurë. I padituri i vetëm i mbetur është Manastiri i Deçanit.

## **2. Kërkesa për ndërhyrje e Komunës së Deçanit**

Pavarësisht se Komuna e pranoi tërheqjen e padisë së NSH-së të drejtuar kundër saj si e paditur e dytë, ajo dëshironte të qëndrojë pranë NSH-së si paditës. Kërkesa e ndërhyrjes në procedurë është bërë kohë më parë; sado që kolegji që ka deklaruar që kërkesa do të shqyrtohej nuk ka marrë një vendim për pranimin ose refuzimin e saj në mënyrë eksplicite dhe informimin e Komunës për përfundimin. Kjo është arsyeja pse ndoshta komuna e kishte konsideruar veten si të ishte një nga paditësit në procedurë.

Më 16.10.2012, gjatë seancës dëgjimore kolegji i specializuar kishte diskutuar mbi kërkesën e ndërhyrjes së komunës për sa i përket qëndrimit pranë paditësit dhe kishte refuzuar atë. Palët dhe komuna u informuan mbi atë se vendimi për zgjidhjen e paraqitur gjithashtu do të përfshijë arsyetimin me shkrim për refuzimin e tillë, por kërkuesi mundet ta kundërshtojë edhe më herët këtë konstatim.

NSH ka avokat të vetin. Tashmë është konstatuar se Zyra e UNMIK-ut për Çështje Ligjore ka qëndrim ligjor si paditës në emër të NSH-së. AKP gjithashtu ka pretenduar të ketë autoritet administrativ mbi NSH-në e cila u refuzua nga Kolegji i Apelit. Kështu NSH nuk ka nevojë për asnjë përfaqësues të mëtijshëm ose administrator apo ndërhyrës për të mbrojtur pozicionin e saj. Më e rëndësishmja, ndërhyrësi e ka bazuar argumentin e tij në faktin se NSH dhe tokat në kontest janë në territorin e tij. Ky fakt nuk i jep të Komunës ndonjë arsye ligjore për të ndërhyrë në ndonjë procedurë kontestimore në lidhje me një tokë brenda territorit të saj. Ndërhyrja mund të lejohet vetëm nga gjykata nëse dispozitivi i aktgjykimit në procedurë do të prodhonte ndonjëherë ndonjë efekt juridik mbi personin që ka kërkuar ndërhyrjen. Edhe në qoftë se padia e paditësit është aprovuar se do të jetë Agjencia ajo e cila do të administrojë këto toka. Pastaj, Agjencia mund edhe të privatizojë asetet e ndërmarrjes shoqërore. Çfarëdo lidhje që ekziston në mes të NSH-ve dhe komunave si për ndarjen e tokave të ndërmarrjeve shoqërore në ligjet e ish-Jugosllavisë ishte ndërprerë që nga 13 qershori 2002 me themelimin e AKM-së nga UNMIK-u. Kështu, komuna nuk ka interes juridik për të ndërhyrë në procedurën pranë NSH-së.

## **3. Regjistrimi në situatën aktuale të kadastrës që nga data e marrëveshjes**

Lidhur me këtë vlen të përmenden Vendimet Ekzekutive të PSSP-së në lidhje me ndryshimet në të dhënat Kadastrale. PSSP-ja, fillimisht me Vendimin Ekzekutiv Nr. 2008/16 të datës 22 prill 2008, vendosi që në mungesë të dokumentacionit provues të ofruar nga Komuna e Deçanit, shënimet në ngastrat e tokës nr. 494, 495, 502, 503, 522, 523, 524, 528, 1104, 1105 dhe 1106 (fleta poseduese Nr. 237) aktualisht e regjistruar në librat kadastrale të Komunës së Deçanit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Ndërmarrja Hoteliere Turistike” Deçan dhe ngastrat e tokës Nr. 943 (fleta poseduese Nr.119) aktualisht e regjistruar në librat kadastrale të Komunës së Deçanit në emër të Ndërmarrjes Shoqërore “Ndërmarrja Publike Banesore” duhet të anulohen përkohësisht me efekt të menjëhershëm dhe të aplikohet *status quo ante*. Vendimi Ekzekutiv do të rishikohet nëse Komuna e Deçanit ia ofron UNMIK-ut dokumentacionin provues të pranueshëm. Gjithashtu në këtë Vendim Ekzekutiv thuhet se kjo do të jetë pa paragjykim në përcaktimin autoritar përfundimtar të të drejtave pronësore në lidhje me ngastrat e tokave në fjalë pas rezultatit të procedurës gjyqësore në vazhdim

para gjykatave kompetente në Kosovë dhe procedurës në vazhdim para Agjencisë Kosovare të Pronës.

Me Vendimin Ekzekutiv pasues Nr. 2008/21, të datës 17 maj 2008, PSSP-ja vendosi që shënimet në Kadastër të anuluar me Vendimin Ekzekutiv Nr. 2008/16, duhet të zëvendësohen me shënimet në të dhënat kadastrale që janë kthyer dhe në pajtim me fletën poseduese Nr. 138 (N95-01-1/97) lëshuar nga Zyra për Kadastrën e Tokës në Pejë më 10 mars 1998. Më tej theksoi se në pajtim me të mësipërmin manastiri ortodoks serb Visoki Deçani do të vazhdojë të gëzojë posedimin e papenguar të ngastrave të tokës Nr. 301 përmes 312 (fleta poseduese aktuale Nr. 131), ngastrat e tokave Nr. 494, 495, 502, 503, 522, 523, 524, 528, 1104, 1105 dhe 1106 (fleta poseduese aktuale Nr. 237) dhe ngastra e tokës Nr. 943 (fleta poseduese aktuale nr. 119). Në rast të një gjykimi autoritativ të drejtave pronësore lidhur me tokat në fjalë nga një gjykatë e Kosovës që ka juridiksionin kompetent, pas rezultatit të procedurës në vazhdim para Agjencisë Kosovare të Pronës, të dhënat kadastrale duhet të pasqyrojnë saktësisht atë gjykim.

Nuk është e njohur për Kolegjin se pse aktvendimi ekzekutiv i UNMIK-ut nr. 2008/21 nuk është pasqyruar në regjistrat kadastrale. Çfarë është e njohur është se të dhënat kadastrale janë ende në emër të NSH-së dhe palët janë në dijeni për këtë fakt, siç mund të kuptohet lehtë nga parashtresat e tyre verbale gjatë seancave të mbajtura në vitin 2008 dhe 2009. Është e panjohur për kolegjin e specializuar nëse palët kanë tentuar ndonjëherë për të ndryshuar të dhënat kadastrale në përputhje me Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut 2008/21 dhe në qoftë se po, pse ai nuk mund të ekzekutohet. Megjithatë, ajo që është e rëndësishme është se tokat në kontest janë ende të regjistruara në emër të paditësit.

Sa i përket dorëzimit të posedimit të parcelave kadastrale, zotërimi i tokave nga i padituri Manastiri tashmë është mbrojtur me vendimin ekzekutiv të përmendura më lart të PSSP-së. Që sot, pasi lënda në pritje para Dhomës së Posaçme është në fazën e saj të hershme në lidhje me zhvillimin e procedurës, Kolegji nuk zotëron asnjë informacion nëse Agjencia Kosovare e Pronës kishte bërë një përcaktim të tillë të përmendur në vendimin ekzekutiv nr 2008/21 të PSSP-së. Poashtu nuk është relevante, pasi padia e paditësit NSH-së që kërkon dorëzimin e posedimit si e tillë nuk do të binte sot nën juridiksionin e Dhomës së Posaçme i cili vepron në bazë të Ligjit Nr 04/L-033 për Dhomën e Posaçme. Dhoma e Posaçme ka juridiksion mbi paditë kundër ndërmarreve të paditura ose agjencisë e jo mbi ato NSH në cilësinë e paditësit kundër personave privatë fizikë ose juridikë. (Neni 4 i lexuar në lidhje me nenin 5.2.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme).

#### **4. Marrëveshja**

Duke marrë parasysh përcaktimin e Kolegjit të Apelit se është Zyra Ligjore e UNMIK-ut, si përfaqësuese e AKM-së, ajo e cila e ka të vetmin qëndrim ligjor në procedurë; dhe duke pasur në vëmendje se e njëjta erdhi në përfundim se NSH-ja mund të përfaqësojë vetëm vetveten përveç nëse AKM-ja merr përsipër procedurën, siç është diskutuar më lartë në detaje, pretendimi i thjeshtë i NSH-së se nuk pajtohet me marrëveshjen gjoja të arritur në mes të AKM-së dhe të paditurit Manastirit ose se ajo duhet të ishte përfaqësuar nga AKP-ja e jo nga AKM-ja, nuk mund të sjellin ndonjë veçori të re në diskutim. Të gjitha atyre argumenteve tanimë iu është përgjigjur shkalla e parë dhe e dytë.

Pas kësaj pike, ajo çfarë Kolegji i Specializuar duhet të kërkojë është nëse marrëveshjen a arritur në mes të Zyrës Ligjore të UNMIK-ut dhe të vetmit të paditur të mbetur Manastirit të Deçanit i plotëson kërkesat e rregullave procedurale dhe çfarë ndikimi juridik që mund të rezultojë nga kjo.

Si parashtresa të rëndësishme në lidhje me vullnetin për të arritur marrëveshje, mund të përmenden si vijon;

- (a) Vullneti për të arritur marrëveshjen i shprehur në parashtrësën e UNMIK-ut/AKM-së të datës 12 maj 2009 dhe kërkesa për seancë dëgjimore për ta paraqitur këtë marrëveshje
- (b) Marrëveshja e shprehur gjatë seancës të mbajtur më 19 maj 2009 dhe
- (c) Kërkesa e bërë më 10 korrik 2009 nga UNMIK-u/AKM-ja ku kërkonin procesverbalin e vërtetuar të seancës dëgjimore të datës 19 maj 2009 dhe ekzekutimin i marrëveshjes
- (d) Marrëveshja e paraqitur me shkrim dhe e shprehur në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012 dhe e plotësuar në pajtim me mendimin e Kolegjit të Apelit të deklaruar në aktvendimin e tij të lëndës ASC-11-0038 të datës 27 dhjetor 2011
- (e) Sqarimi dhënë në parashtrësën e datës 29 tetor 2012
- (f) Teksti i nënshkruar jashtë gjykatës dhe i bashkangjitur në parashtrësën e datës 3 dhjetor 2012.
- (g) Konfirmimi i tekstit të marrëveshjes gjatë seancës dëgjimore të mbajtur më 21 dhjetor 2012

Tri të parat nuk ishin konsideruar më parë si një marrëveshje e duhur në përputhje me rregullat procedurale nga ana e trupit gjykues dhe kolegjit të apelit. Analiza e detajuar e arsytimit të këtyre kolegjeve për refuzim të tillë mund të gjenden në arsyetimin ligjor të aktgjykimit në lëndën nr. SCC-08-0226.

Çfarë ia vlen të theksojmë këtu është të kuptuarit e Kolegjit të Apelit lidhur me atë se si mund të arrihet një marrëveshje në pajtim me procedurat ligjore. Kolegji i Apelit theksoi shpjegimin e Trupit Gjykues mbi procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 19 maj 2009, gjatë të cilës ata i kishin bërë deklaratat e tyre e që këto përbëjnë marrëveshjen e tyre por procesverbali ishte nënshkruar nga palët në data të ndryshme. Nënshkrimi i përfaqësuesit të paditësit mban datën 22 qershor 2009 ndërsa ai i të paditurit mban datën 8 korrik 2009. Kolegji i Apelit i dha rëndësi këtyre datave të ndryshme të nënshkrimit të procesverbalit. Në interpretimin e Kolegjit të Apelit, për atë që UA-ja e UNMIK-ut Nr. 2008/6 në nenin 26.4 kërkon që një marrëveshje e tillë duhet të jetë me shkrim, formulimi i këtij neni nënkupton që një marrëveshje duhet të paraqitet me shkrim nga palët jashtë seancës dëgjimore. Të citojmë nga ai Aktvendim *“...pas marrëveshjes me shkrim, të dorëzuar Trupit Gjykues, Gjykata mund të mbyllë lëndën, dhe palët janë të lirë që të japin përmbarimin e marrëveshjes së tyre me instrumentet ligjore të parapara me ligj në këtë shkallë”*.

Sipas Kolegjit të Apelit, një formë tjetër e marrëveshjes brenda Gjykatës është paraparë me nenin 322 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK e mëparshme), i zbatueshëm në procedurën para DHPGJS-së në bazë të nenit 70.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6. Neni në fjalë thotë *“Marrëveshja e palëve mbi pajtimin përfshihet në procesverbal. Pajtimi qubet i përfunduar kur palët pas leximit të procesverbalit mbi pajtimin e nënshkruajnë procesverbalin. Palëve, me kërkesën e tyre do t'i jepet kopja e legalizuar e procesverbalit, ku është përfshirë pajtim?”*

Pas dhënies së këtyre shpjegimeve, Kolegji i Apelit erdhi në përfundim se në lëndën në fjalë procedura e paraparë me dispozitën e mësipërme nuk ishte respektuar pasi që palët kanë nënshkruar procesverbalin në data të ndryshme. Sipas Kolegjit të Apelit, neni 322 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, siç mund të kuptohet me një lexim të plotë të ligjit, nënkupton që marrëveshja duhet të bëhet në të njëjtën kohë nga palët, gjatë të njëjtës seancë dëgjimore, të cilët e nënshkruajnë marrëveshjen para gjyqtarit përgjegjës në seancën dëgjimore publike, “pasi tu lexohet procesverbali”.

Sidoqoftë, Kolegji i Apelit vuri në dukje se palët kishin shprehur vullnetin e tyre që të zgjidhin kontestin dhe prandaj, Trupi Gjykues do të duhej të caktoj një seance tjetër dëgjimore në mënyrë që të shqyrtoj mundësinë e një marrëveshje të tillë të arritur në pajtim me dispozitat e aplikueshme.

Kolegji i Apelit ka heshtur sa i përket mos-lëshimit të procesverbalit tek palët siç është kërkuar nga Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut.

Një tjetër pikë e ngritur nga Kolegji i Apelit ishte se sido që të jetë përmbartimi i kësaj marrëveshje nuk bie në juridiksionin e Dhomës së Posaçme.

Më 20 qershor 2012, lënda u transferuar në juridiksionin dhe kompetencën e Kolegjit për Çështje Pronësore, si rezultat i Vendimit të Presidiumit Nr. 19/2012. Kolegji për çështje pronësore, në bazë të kërkesës së Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dhe duke marrë parasysh Aktvendimin e Kolegjit të Apelit caktoi një seancë tjetër dëgjimore. Seanca dëgjimore u mbajt më 16 tetor 2012.

Në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012; teksti i marrëveshjes i bërë me shkrim dhe i nënshkruar jashtë gjykatës ishte lexuar. Përfaqësuesi i UNMIK-ut dhe i padituri Manastiri konfirmuan tekstin e lexuar atyre. Palët ishin urdhëruar që t'i dorëzojnë gjykatës dokumentet e munguara të cilat tregojnë personalitetin ligjor të Manastirit të Deçanit dhe vërtetimin e të drejtës së Manastirit për të vendos dhe tërheqë çfarëdo të drejte lidhur me cilëndo ngastër kadastrale që ishte objekt i padisë pa pasur nevojë që të jetë e përfaqësuar nga ndonjë institucion tjetër në Kosovë apo Serbi dhe përfaqësimin nga kryemurgu, at Sava Janjic, si i autorizuar duke i dhënë autorizim avokatit Z. Aleksander Radovanovic. Kjo Përshkak të faktit që, sipas tekstit të marrëveshjes, Manastiri jo vetëm që pranon heqjen dorë nga padia e UNMIK-u për disa ngastra, por gjithashtu heqjen dore nga e drejta mbi disa ngastra në dobi të NSH-ve apo personit(personave) privat te cilat janë jashtë Zonës së Veçantë.

Me urdhër të Gjyqtarës Kryesuese të datës 23.10.2012, procesverbali i seancës së mbajtur më 16.10.2012 ishte dërguar tek palët që paraqitën marrëveshjen. At ishin ftuar që të kontrollojnë dhe nënshkruajnë procesverbalin në prani të Gjyqtarës kryesuese në të njëjtën datë për konfirmimin e marrëveshjes. Më 15.11.2012, përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dhe at Sava Janjic, kryemurgu i Manastirit të Deçanit, dhe avokati i Manastirit nënshkruan procesverbalin në të njëjtën kohë.

Dokumentet që mungojnë, sikurse edhe përkthimi në gjuhën Serbe i marrëveshjes ishin paraqitur nga palët brenda afatit kohorë të dhënë nga Gjyqtarja kryesuese gjatë seancës së 16 tetorit 2012. Për mëteper, Kolegji kërkoi sqarim nëse marrëveshja ka lënë jashtë saj disa ngastra kadastrale pasi që disa ngastra që janë objekt i padisë nuk ishin përmendur në marrëveshje. Palët ofruan sqarimin dhe edhe njëherë konfirmuan marrëveshjen e tyre në seancën dëgjimore të mbajtur më 21 dhjetor 2012.

Në seancën e mbajtur më 21 dhjetor 2012, avokati i NSH-së kundërshtoi marrëveshjen e arritur nga UNMIK-u dhe Manastiri i Deçanit. Ky argumentoi se AKP-ja do të ishte dashur të thirrej në seancë dëgjimore dhe të përfaqësoj NSH-në. Ai argumentoi më tutje se përfaqësuesi do të duhej të punoj në favor të interesit të klientit të tij e jo kundër.

Sa i përket rregullave procedurale, paraqitja e marrëveshjes mu tani, madje edhe ajo e shprehur në seancën dëgjimore të datës 19 maj 2009 ishte e kompletuar në interpretimin e Kolegjit të tanishëm të Specializuar për Çështje Pronësore. Gjyqtarja Kryesuese deklaroi se Gjykata do të preferonte të ketë një tekst me shkrim dhe iu dha kohë atyre që të jenë të qartë në përmbajtjen e marrëveshjes. Megjithatë, përfaqësuesi i Manastirit deklaroi qartë se atyre nuk iu duhet kohë për këtë dhe e pranuan ofertën e bërë nga përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut. Oferta dhe pranimi i ofertës është i mjaftueshëm që të vendoset se është arritur marrëveshje. Ky është parimi themelor i ligjeve që rregullojnë fushën e kontratave dhe detyrimeve në shumë sisteme juridike se si të arrihet një marrëveshje/kontratë. Sido që të jetë, vullneti i lirë i palëve ishte paraqitur në procesverbalin e datës 19 maj 2009 dhe ai procesverbal ishte nënshkruar nga ata edhe pse nënshkrimi i procesverbalit nga palët ishte bërë në tjetër kohë. Megjithatë, Kolegji siç u përmend më lartë e konsideron se ai kufizohet me interpretimin e Kolegjit të Apelit në atë se si të arrihet marrëveshja.

Sipas Ligjit aktual mbi Procedurën Kontestimore, neni 416 i LPK-së (Ligji Nr. 03/L-006) e rregullon formën e marrëveshjes dhe përcakton mënyrën e arritjes së saj. Sipas këtij neni, marrëveshja

përfshihet në procesverbalin e takimit. Pajtimi gjyqësor është i përfunduar në momentin kur palët e lexojnë procesverbalin e takimit mbi pajtimin dhe e nënshkruajnë atë. Kopja e vërtetuar e procesverbalit të takimit, duke përfshirë marrëveshjen, u jepet palëve. Një marrëveshje e tillë e paraqitur në seancën e mbajtur më 16 tetor 2012 dhe teksti i plotësuar i bashkangjitur në parashtrësën e datës 03 dhjetor 2012 është konsideruar të jetë në pajtim me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit dhe e bërë në pajtim me nenin 26 të UA-së së UNMIK-ut Nr. 2008/6 dhe shtojcës së LDHP-së, dhe se marrëveshja e tillë ishte kompletuar dhe është në pajtim me nenin 416 të LPK-së gjithashtu.

## **5. Mungesa e kundërpadisë**

Zyra për Çështje Ligjore e UNMIK-ut ka kërkuar lëshimin e një urdhri për ndryshimin në librat e Kadastrës për të reflektuar marrëveshjen në të dhënat kadastrale. Megjithatë, deri më tani nuk ka asnjë kundërpadi apo padi të veçantë të parashtruar nga i padituri Manastiri i Deçanit për verifikimin e të drejtave pronësore mbi tokën në fjalë dhe/apo regjistrimin e tyre në regjistrat e Kadastrës në emrin e tij.

Marrëveshja dhe efekti detyrues i saj e arritur nga palët në një procedurë në pritje për t'u zgjidhur është një koncept tjetër ligjor e jo një pranim i padisë apo kundërpadisë. Pa pasur kundërpadi, Gjykata mund të vendosë vetëm në efektin e marrëveshjen mbi kompensimin e kërkuar në një procedurë në pritje për tu zgjidhur në bazë të një padie.

Çfarë mund të vendosë Kolegji i Specializuar kufizohet në padinë e NSH-së. Ajo ose mund të miratojë kompensimin e kërkuar me të apo ta refuzojë. Duke marrë parasysh se i padituri nuk ka parashtruar kundërpadi e cila do t'i nënshtrohej disa afateve që tanimë kanë skaduar, Kolegji mund të marrë qëndrim vetëm për kërkesën e paditësit në procedurën aktuale. Pajtimi gjyqësor mund të arrihet vetëm nëse ngrehet padi (neni 418.1 i LDHP-së).

## **6. Kompensimi që mund të miratohet në bazë të marrëveshjes**

I vetmi kompensim që mund të miratohet në bazë të kësaj marrëveshje në lëndën në fjalë, është të refuzohet padia për disa ngastra. Neni 26 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6 apo Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme nuk e shpreh në mënyrë eksplicite se çfarë lloj veprimesh duhet të merren nga Kolegji në bazë të një marrëveshje. Kjo dispozitë vetëm e përcakton se një marrëveshje e tillë është detyruese për palët dhe asgjë tjetër. Këtë çështje e mbulon Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

Në bazë të nenit 417 të LPK-së, gjatë gjithë procesit gjyqësor gjykata konsideron nëse ai është duke u zhvilluar me padinë nëse ka ardhur deri te marrëveshja, dhe nëse konsideron se padia është adresuar e refuzon padinë. Ngastrat kadastrale për të cilat Manastiri ka hequr dorë nga e drejta e tij, janë tashmë të regjistruara në emër të NSH-së, prandaj nuk ka nevojë për ndryshime në kadastrë. Bazuar në marrëveshje, tani Kolegji vërteton se e drejta e pronësisë së paditësit mbi këto ngastra nuk do të mund të atakohet nga Manastiri në të ardhmen. Pra, i vetmi përcaktim që mund të bëhet tani nga Gjykata për sa i përket marrëveshjes është të refuzohet padia si e pabazuar.

Pjesa tjetër nuk është në kompetencë të Kolegjit të Specializuar. As nuk ka kundërpadi apo padi të veçantë të parashtruar nga i padituri për t'u bashkuar me këtë, për të fituar të drejtën e pronësisë mbi tokat në fjalë apo ku kërkohet verifikimi i pronësisë apo regjistrimi i tyre në emrin e tij. Ia vlen të theksohet se dispozitivi është detyrues vetëm për palët në këtë kontest gjyqësor dhe jo personat e tretë që pretendojnë të drejta pronësie mbi ngastrat e njëjta kadastrale.

## **7. Ekzekutimi i marrëveshjes**

Përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të UNMIK-ut dorëzoi parashtrësë më 19 nëntor 2012 ku kërkoi kopjen e vërtetuar të procesverbalit të seancës së mbajtur më 16 tetor 2012 si dhe lëshimin e një urdhri për Kadastrën duke e udhëzuar atë që të regjistrojë ngastrat kadastrale në kontest në emër të manastirit të paditur. Procesverbali i seancës dëgjimore në fjalë tashmë i ofruar sidhe procesverbali i vërtetuar do t'iu ofrohet palëve dhe do t'iu dërgohet atyre bashkëngjitur me këtë aktgjykim.

Për sa i përket lëshimit të urdhri për ndryshime në Kadastër për të mundësuar ekzekutimin e marrëveshjes së tyre të arritur në mes të UNMIK-ut dhe Manastirit:

Sipas nenit 414 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (Ligji Nr. 03/L-006);

Me anë të pajtimit gjyqësor mund të përfshihet e gjithë kërkesëpadija apo vetëm një pjesë e saj. Gjykata bien një urdhër lidhur me marrëveshjen ligjore. Megjithatë, palët nuk mund të arrijnë pajtim përmes gjykatës nëse padija ka të bëjë me të drejtat e tyre të cilat ata nuk i disponojnë lirisht (neni 3, paragrafi 3 i LDHP-së). Në një situatë të tillë, palët arrijnë në një marrëveshje mbi të drejtat të cilat ata nuk i disponojnë lirisht, gjykata do të përfshijë në procesverbalin e seancës dëgjimore marrëveshjen në mes të palëve e cila më vonë mund të vlerësohet nga gjykata e apelit për vlefshmërinë e saj (neni 414.4 i LDHP-së). Kështu, marrëveshja e arritur nga palët mund të jetë objekt i ankesës dhe palët e treta mund ende të kërkojnë se të drejtat nuk janë ato që palët i disponojnë lirshëm.

Përndryshe, një marr e tillë është detyruese për palët në pajtim me nenin 26 të Shtojcës së Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, dispozitë e hollësishme e cila nuk kërkon zbatimin e LDHP-së, ose në këtë kuptim në lidhje me nenin 14 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe/ose nenin 70.3 të UA-së s UNMIK-ut Nr. 2008/6.

Megjithatë, ekzekutimi i një marrëveshje të tillë nuk bie në juridiksionin e Dhomës së Posaçme. Dhoma e Posaçme nuk ka juridiksion mbi ekzekutimin e as madje të vendimeve apo aktgjykimeve të veta. Gjykatat e rregullta kanë juridiksion mbi kërkesat e ekzekutimit. Natyra detyruese e marrëveshjes në mes të palëve nuk e ndryshon këtë fakt.

Nëse palët dëshirojnë të ekzekutojnë marrëveshjen e tyre, ata janë të lirë të marrin veprimet e nevojshme para autoriteteve administrative duke paraqitur procesverbalin e vërtetuar të nënshkruar nga ata në marrëveshjen e arritur para Dhomës së Posaçme në këtë lëndë dhe të vërtetuar dhe dërguar atyre nga Gjykata bashkë me këtë Aktgjykim. Në rast të mospajtimit të autoriteteve administrative në marrëveshjen e tyre, ata mund të paraqesin kundërshtimet e tyre në kuadër të procedurës administrative.

Apo ndryshe, ata mund të kërkojnë ekzekutimin e këtij aktgjykimi para gjykatës së rregullt kompetente nëse dhe kur ai të bëhet i formës së prerë. Vlen të thuhet se një kërkesë e tillë për ekzekutim ende do të bie jashtë juridiksionit të Dhomës së Posaçme.

### **Shpenzimet**

Palët nuk kanë marrë qëndrim për sa i përket shpenzimeve. Kështu, asnjëra palë nuk kërkon kompensim në të holla. Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore, Kolegji vendosi se nuk nevojitet ngarkimi i shpenzimeve pasi që ende nuk ka një plan me shkrim të gjykatës që është aprovuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës në pajtim me nenin 57.2 të Shtojcës të LDHP-së.

### **Këshilla ligjore**

Marrëveshja e arritur nga palët është detyruese për ta në pajtim me nenin 26 të Shtojcës së LDHP-së. Një marrëveshje e tillë mund të kundërshtohet nga ata vetëm në kushtet e përcaktuara në nenin 418.2 të LPK-së.

Në rast se ndonjë person pretendon se të drejtat procedurale të tij/saj janë shkelur apo që ai/ajo/ ka të drejt substanciale mbi objektin e kësaj lënde apo synon të atakoj marrëveshjen e arritur; Kolegji iu rikujton që procedura apeluese është si në vijim:

Në bazë të nenit 10.6 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, ankesa kundër aktgjykimin mund të parashtrohet me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit brenda njëzetën (21) ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi apo dijenia për të. Në bazë të të njëjtit nen ankesa duhet t'u dërgohet palëve tjera brenda të njëjtit afat nga ankuesi dhe prova e dërgimit t'i bashkëngjitet ankesës. Kolegji i Specializuar, në lidhje me këtë, ua kujton edhe dispozitën e nenit 59 të Shtojcës. Kolegji i Apelit mund ta refuzojë ankesën, kështu ky Aktgjykim do të bëhet i formës së prerë, nëse palët nuk e përmbushin dispozitën e nenit 10.6 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme dhe nenit 59 të Shtojcës brenda afatit të paraparë.

Nëse ankesa e atyre që pretendojnë interesa të tilla është e pranueshme apo jo duhet të vlerësohet nga Kolegji i Apelit.

Esmë Erterzi,  
Gjyqtare Kryesuese, EULEX